



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_ Datë \_\_. 04. 2026

**“ MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR BASHKINË  
KOLONJË”**

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", si dhe në zbatim të Urdhrit nr.281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në Informacion, me propozim të kryetarit të bashkisë, këshilli i bashkisë Kolonjë në mbledhjen e datës . 04.2026:

**PROPOZOI:**

1. Miratimin e përditësimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Kolonjë në përputhje me Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të miratuar me Urdhrin nr.281, datë 30.12.2025.
2. Programi i përditësuar i Transparencës është pjesë përbërëse e këtij projekt- vendimi dhe i bashkëlidhet si Lidhja nr.1.
3. Programi i Transparencës të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Kolonjë në seksionin "Programi i Transparencës”, si dhe në mjediset e caktuara për njoftimet publike në Bashki dhe njësitë administrative.
4. Programi i Transparencës të përditësohet rregullisht në përputhje me ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore përkatëse.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Koordinatori për të Drejtën e Informimit, specialisti IT dhe të gjitha drejtoritë e Bashkisë Kolonjë.

**KRYETAR  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
NËNKRYETAR  
PETRO RISTO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PUBLIK

Nr. 2165,

Datë: 02/04 2026

RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ .04.2026

“ MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR BASHKINË  
KOLONJË”.

*Të nderuar!*

Programi i ri Institucional i Transparencës (PT), synon të rrisë shkallën e llogaridhënies dhe aksesin e qytetarëve në informacionin publik të Bashkisë Kolonjë. Ky dokument vjen si nevojë e përshtatjes me standardet më të fundit të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, duke zëvendësuar kështu formatin e vjetër të vitit 2018. Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, neni 6, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe të Urdhërit nr. 281 datë 30.12.2025 Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për miratimin Programit Model të Transparencës për Njesitë e Vetëqeverisjes Vendore", Bashkia Kolonjë do të miratojë Programin e Ri Institucional të Transparencës (PT) sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me Lidhjen nr. 1 (bashkëlidhur Urdhërit nr. 281 datë 30.12.2025 të Komisionerit për Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ), sipas Lidhjes nr. bashkëlidhur ketij Relacioni. e të 1 Programi i ri i Transparencës (PT), është i strukturuar në 8 fusha kryesore, duke mbuluar çdo aspekt të veprimtarisë së Bashkisë Kolonjë:

Fusha 1 & 2 e (Organizimi administrativ - territorial, misioni dhe funksionet Bashkise Kolonjë dhe Transparenca dhe llogaridhënia ekonomike - financiare): Kërkon publikimin e strukturës, pagave, buxhetit vjetor dhe raporteve të auditimit.

Fusha 3 (Kërkesat për informim): Të dhënat personale të Koordinatorit të së Drejtës së Informimit duhet të jenë publike, si dhe regjistri i kërkesave dhe i kthimit të përgjigjeve qytetarëve të interesuar, të publikohen në faqen zyrtare të webit të Bashkisë Kolonjë [www.kolonja.gov.al](http://www.kolonja.gov.al).

Fusha 4 (Shërbimet): Bashkia duhet të bëjë publike listën e shërbimeve administrative, tarifave përkatëse dhe procedurat për përfitimin e tyre.

Fusha 5 (Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore): Bashkia Kolonjë duhet të publikojë të gjithë legjislacionin si dhe aktet e brendshme rregullatore që zbaton në përditshmëri.

Fusha 6 (Pjesëmarrja qytetare ne vendimmarrje): Përcakton detyrimin për njoftimin e konsultimeve publike dhe publikimin e raporteve vjetore mbi komentet e pranuar nga qytetarët.

Fusha 7 (Informacion tjetër): Këtu përfshihet bërja publike e informacionit mbi të dhënat e projekteve në kuadrin e integritit në Bashkimin European, të dhëna për OJF- të si dhe nisma advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile, bërjen publike të raporteve, studimeve dhe vlerësimeve mbi zbatimin e Programit te Transparencës.

Fusha 8 (Këshilli Bashkiak): Kjo është risia kryesore e (PT), ku kërkohet publikimi i listës së këshilltarëve,biografia e tyre si dhe nr e tyre te kontaktit. Informacion rreth komisioneve ku përfshihet bërja publike e përbërjes së komisioneve, njoftimi për takimet e komisioneve, axhenda dhe dokumentat për diskutim si dhe raportet mbledhjeve të komisioneve për projekt-vendimet e diskutuara, si dhe kuadri ligjor rregullator i Këshillit Bashkiak Kolonjë.

Miratimi i këtij programi nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një dritare e vogël për të siguruar që çdo qytetar i Kolonjë të ketë akses të shpejtë, pa kërkesë dhe pa pagesë në dokumentet zyrtare, duke rritur besimin te qeverisja lokale.

**Konceptoi: Koordinatori për të Drejtën e Informimit Publik**

Xh. Kalemaj

**Konfirmoi: Drejtori D.C.J.P.O.Lifo**

**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
NËNKRYETAR  
PETRO RISTO**